

URDHËR
Nr.193/4, datë 15.5.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 193, DATË 20.3.2020
“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193, datë 20.3.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në tabelën bashkëlidhur urdhrit bëhet ky ndryshim:

131	Bibliotekat, arkivat, muzeumet dhe të tjera aktivitete kulturore	Lejohen (Përjashtohen aktivitetet kulturore, të cilat vijojnë të jenë të mbyllura deri në një urdhër të dytë.)
-----	--	---

2. Aktivitetet e përcaktuara si të lejuara në pikën 1 të këtij urdhri, të respektojnë rregullat e distancimit social dhe të higjenës, sipas protokolleve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

3. Çdo parashikim që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu